



RONELA BUJARAJ

Nga pasiguria në vendosmërinë për të ndërtuar

Në klasën e nëntë, si shumë bashkëmoshatarë të saj, ajo ndjehej e pasigurt. Zgjedhjet e jetës dukeshin të shumta, por përgjigjet të pakta. Çfarë duhej të zgjidhte? Cili ishte talenti i saj? A do ta ndihmonin notat për të hyrë në një shkollë të mirë? Pyetje që rëndonin mbi supet e një 14-vjeçareje që kërkonte të gjente veten.

E gjitha ndryshoi kur ajo mori pjesë në këshillimin e karrierës. Një proces që për shumë mund të duket formal. Pas intervistës individuale, analizës së interesave dhe testimit të aftësive, ajo për herë të parë pa një pasqyrë të qartë përpara: një grup profesionistësh e ndihmuan të shihte që ajo kishte diçka unike për të ofruar. Në atë moment, e ndjeu me siguri: *"Po, kjo është rruga ime"*.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

IPikërisht atëherë, në një listë që përfshinte fusha të ndryshme, ajo zbuloi diçka që më parë as që e kishte marrë në konsideratë: arkitekturën. Deri atëherë, kjo i ishte dukur një fushë e ndërlikuar, larg saj. *“Duke qenë se unë kam pas probleme për të përmirësuar notat në disa lënde mendoja se kjo gjë do të ndikonte në arsimin tim të lartë në lidhje me pranimin, mesataren e notave”,* tregon Ronela për pasigurinë e saj.

Këshillimi nuk i tregoi vetëm një profesion, i tregoi që pasioni nuk është e vetmja gjë që ka rëndësi. Është po aq e rëndësishme të ndihesh mirë me atë që bën, të ndjesh që puna jote nuk është thjesht një detyrë, por një mjet për të shprehur veten. Sot, ajo e di se profesioni që ka zgjedhur nuk do të jetë një punë e lodhshme, por një rrugëtim që do ta përjetojë me pasion dhe vetëbesim.

“Zgjodha profesionin e arkitektit. Më ngjalli kuriozitet sepse pash që ishte një profesion ku unë kisha në dorë të shfrytëzoja fantazinë time, duke e kthyer në një objekt ose një shtëpi ku individët do të ndihen me të vërtetë në shtëpi”, shton Ronela detaje nga historia e saj se si Këshillimi në karrierë e ndriçoi së brëndshmi drejt vendimit final. *“Nuk e kisha konsideruar këtë profesion sepse nuk më dija që isha e prirur”.*

Vështirësitë me disa lëndë, presioni për të pasur nota të larta, frika se ato do të ndikojnë në pranimin në shkollë, të gjitha këto e bënë të mendojë se ndoshta nuk do ia dilte.

Por, më pas kuptoi që ky sistem, pavarësisht vështirësive, i ofron mundësi: trajnimet, projektet dhe vetë mundësia për këshillim janë mjete të vlefshme për ta ndihmuar të ecë përpara.

Në këtë rrugë nuk ishte vetëm. Prindërit e saj ishin mbështetës, të hapur ndaj përvojave të reja dhe e panë këshillimin si një hap shumë të rëndësishëm. Ata nuk e shtynë drejt ndonjë zgjedhjeje, por e mbështetën që të gjente vetë atë që e përmbushte më shumë.

“Vazhdo këshillimin, sepse do të ndihesh më e sigurt dhe më e qartë për të ardhmen” është këshilla e Ronelës sot, duke përfunduar se nuk ka më pasiguri, por vetëm dëshirë për të ndërtuar, për të krijuar dhe për të sjellë në jetë idetë që ka në shpirt. Falë këshillimit të karrierës, e di që është në rrugën e duhur.

